

CORE TOPICS

2020 Census recommendations	2011 Census recommendations	Shpjegimi
No		
I	POPULATION TO BE ENUMERATED	
II	GEOGRAPHIC CHARACTERISTICS	
Vendndodhja e banesës	X	Banesat janë ato lloje strehimi të cilat shërbejnë si vend i zakonshëm banimi i një ose më shumë personave (pavarësisht nëse janë apo jo të pranishëm atje në momentin e censit). Prandaj, është e mundur që ato të klasifikohen në të njëjtin nivel gjeografik detajimi si "vendi i vendbanimit", dhe nivele të mëtejshme detajimit mund të përdoren, por shkalla në të cilën bëhet kjo do të ndryshojë sipas nevojave statistikore të çdo vendi.
Vendndodhja e vendit të punës	X	Vendndodhja e vendit të punës është vendi i saktë në të cilin një person i punësuar aktualisht kryen punën e tij / saj. Vendndodhja duhet të kodohet në adresën e saktë dhe / ose në koordinatat gjeografike, nëse kjo nuk është e mundur, në ndarjen më të vogël të mundshme civile
III	DEMOGRAPHIC CHARACTERISTICS	
Gjinia	X	Gjinia e çdo personi duhet të regjistrohet në cens. Gjinia, së bashku me moshën, janë çështjet që përdoren më shpesh në klasifikimin e ndërthurur të popullsisë me karakteristika të tjera të saj. Prandaj, është thelbësore që informacioni mbi gjininë të jetë sa më i plotë dhe i saktë të jetë e mundur. Nëse ky informacion mungon, duhet të ndërmerret një imputim i bazuar tek individët e tjerë ose tek anëtarët e tjerë të njësisë ekonomike familjare.
Mosha	X	Për të marrë informacion mbi moshën, rekomandohet mbledhja e informacionit mbi datën e lindjes. Kjo jep informacion më të saktë sesa mbledhja e të dhënave mbi moshën e saktë në kohën e referimit të censit. Mbledhja e informacionit mbi datën e lindjes lejon tabulimin e të dhënave në dy mënyra: sipas vitit të lindjes dhe viteve të mbushura. Data e lindjes gjithashtu lejon llogaritjen e moshës në lidhje me pika të tjera në kohë, të ndryshme nga koha e referimit të censit. Duke qenë se mosha është një nga variablat më të rëndësishëm të mbledhur në një regjistrim, të përdorur në shumë tabela dhe analiza, është thelbësore që informacioni mbi moshën të jetë sa më i plotë dhe i saktë që të jetë e mundur.
Statusi martesor ligjor	X	Statusi martesor ligjor përcaktohet si statusi (ligjor) bashkëshortor i çdo individi në lidhje me ligjet (ose zakonet) e martesës (shpesh quhet edhe statusi martesor de jure). Informacioni mbi statusin ligjor martesor të çdo personi duhet të mblidhet së paku për personat e moshës 15 vjeç e lart. Sidoqoftë, meqenëse mosha minimale (ose mosha zakonore) për martesë ndryshon midis vendeve dhe pasi që popullsia mund të përfshijë edhe të rinjtë që janë martuar në vende të tjera me moshë minimale më të ulët, inkurajohet grumbullimi i të dhënave për të gjithë personat .
Statusi martesor de facto		Statusi martesor de facto përcaktohet si statusi i çdo individi në lidhje me aranzhimet aktuale të jetesës brenda familjes dhe ky informacion merret pavarësisht nga statusi juridik martesor i atij personi. Rekomandohet që informacioni mbi këtë çështje të mblidhet për personat e të njëjtave mosha si ato për të cilat mblidhen të dhëna për statusin ligjor martesor.
IV	ECONOMIC CHARACTERISTICS	

CORE TOPICS

2020 Census recommendations	2011 Census recommendations	Shpjegimi
Statusi në forcën e punës	X	"Klasifikimi i personave sipas statusit të tyre në forcën e punës siguron informacion të rëndësishëm lidhur me qasjen e tyre në tregun e punës, në veçanti, me punën e kryer kundrejt pagesës ose fitimit, në një periudhë të shkurtër referimi. Personat mund të klasifikohen, në lidhje me një periudhë të shkurtër referimi, sipas në forcën e punës, si 'të punësuar', 'të papunë' ose 'jashtë fuqisë punëtore'.
Profesioni	X	"Profesioni" nënkupton llojin e punës së kryer në punën kryesore nga personi i punësuar (ose në punën e fundit të mbajtur nëse personi është i papunë) siç përcaktohet nga detyrat kryesore të kryera në punë, pavarësisht nga aktiviteti ekonomik në të cilën është klasifikuar puna e personit apo statusit të punësimit.
Aktiviteti ekonomik	X	Aktiviteti ekonomik i referohet llojit të prodhimit apo aktivitetit të ndërmarrjes në të cilën është kryer puna kryesore e personit të punësuar, ose puna e fundit në rastin e një një personi të papunë."
Statusi në punësim	X	Statusi në punësim' nënkupton llojin e kontratës eksplicite ose të nënkuptuar të punësimit me personat ose organizatat e tjera, që personi ka në punën e tij / saj. Kriteret themelore të përdorura për të përcaktuar grupet e klasifikimit janë lloji i rrezikut ekonomik, element i së cilës është forca e lidhjes midis personit dhe punës, dhe llojin e autoritetit mbi objektet dhe punëtorët e tjerë, të cilët personi ka në punë. Statusi në punësim mund të klasifikohet si më poshtë: 1. I punësuar me pagë 2. i vetëpunësuar me të punësuar kundrejt një page 3. i vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page 4. Punëtor pa pagesë i familjes
V	AGRICULTURE	
VI	EDUCATIONAL CHARACTERISTICS	
Niveli arsimor I arritur	X	Niveli arsimor i arritur nga një individ, përcaktohet si niveli më i lartë i përfunduar me sukses, sipas klasifikimit ISCED. Ky nivel zakonisht matet në lidhje me programin më të lartë të arsimit të përfunduar me sukses dhe që njëkohësisht vërtetohet nga një dokument i njohur kualifikimi.
VII	MIGRATION	
Vendlindja		Vendlindja është shteti në të cilin ndodhet vendi i lindjes së një personi. Vendlindja përdoret për të bërë dallimin midis banorëve vendas dhe atyre të huaj. Duhet të theksohet se vendlindja e një personi nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me vendin e tij të shtetësisë, e cila është një temë e veçantë e censit. Vendlindja mund ti referohet ose vendit ku ka ndodhur lindja fizike ose vendit në të cilin nëna zakonisht banonte në kohën e lindjes nëse kjo është e ndryshme.
Shtetësia	X	Shtetësia' përkufizohet si lidhja e veçantë juridike midis një individi dhe shtetit të tij, të fituar me lindje ose natyralizim, qoftë me anë të deklaratës, opsionit, martesës ose mjeteve të tjera sipas legjislacionit kombëtar. Shtetësia përdoret për të identifikuar popullsinë e shtetasve të huaj, që janë, ata persona që banojnë në vend, por që nuk mbajnë nënshtetësinë e atij vendi të numërimit.

CORE TOPICS

2020 Census recommendations	2011 Census recommendations	Shpjegimi
Jetesa ndonjëherë jashtë shtetit dhe viti I kthimit	X	Kjo temë fokusohet në të gjithë personat që kanë jetuar ndonjëherë jashtë vendit aktual të vendbanimit të zakonshëm, pavarësisht nga vendi i lindjes ose nënshitetësisë, dhe pavarësisht nga ndryshimet e tjera të vendbanimit të zakonshëm që mund të kenë ndodhur brenda vendit. Për të mbledhur informacion mbi këtë temë, individët duhet të klasifikohen në varësi të faktit nëse ata kanë pasur ndonjëherë një qëndrim të zakonshëm jashtë vendit. Informacioni mbi këtë temë lejon identifikimin e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë. Për ata që kanë banuar ndonjëherë jashtë vendit, duhet të mblidhen informacion edhe për vitin e mbërritjes në vendin aktual të banimit.
Vendi I mëparshëm I vendbanimit të zakonshëm dhe viti I ardhjes në vendbanimin aktual	X	Kjo çështje jep informacion mbi modelet gjeografike dhe kohore të lëvizjeve të migrimit drejt vendit aktual të banimit. Rekomandohet që vendi i vendbanimit të mëparshëm të identifikohet deri në ndarjen më të vogël civile.
VIII ETHNO-CULTURAL CHARACTERISTICS		
IX DISABILITY		
X HOUSEHOLD AND FAMILY CHARACTERISTICS		
Lidhja me personin e referencës	X	Për të gjithë personat që jetojnë në një Njësi Ekonomike Familjare, duhet të mblidhet informacion mbi lidhjen e tyre me anëtarët e tjerë të Njëf-së. Të dhënat për këtë temë nevojiten për përdorim në (a) identifikimin e bërthamave familjare dhe Njësitë Ekonomike Familjare (b) nxjerrjen e statusit të Njëf-së dhe statusin familjar të secilit prej anëtarëve.
Njëf - të sipas statusit të pronësisë së banesës	X	Kjo çështje ka të bëjë me mënyrën sipas të cilës një Njësi Ekonomike Familjare zotëron të tërë ose një pjesë të njësisë së banimit .
XI HOUSING CHARACTERISTICS		
Lloji I banesës	X	Banesa' janë ato lloje strehimi që shërbejnë si vendbanim i zakonshëm për një ose më shumë persona. Ato janë struktura të ndara dhe vende të pavarura banimi që: (a) janë ndërtuar, shndërruar ose rregulluar për banim njerëzor, me kusht që ato të mos jenë duke u përdorur për qëllime të tjera dhe të kenë qënë të banuara në momentin e censit; ose (b) ndonëse nuk kishin për qëllim të banonin, ishin në përdorim për një qëllim të tillë në momentin e censit.
Statusi I banimit - banesat e zakonshme	X	Statusi i banimit i referohet faktit nëse një banesë e zakonshme është apo jo vendi i vendbanimit të zakonshëm i një ose më shumë personave.
Statusi I pronësisë së banesës	X	Kjo çështje i referohet llojit të pronësisë së banesës si e dallueshme nga toka në të cilën ndodhet banesa.
Number I banorëve	X	Numri personave në një banesë është numri i personave për të cilët kjo banesë shërben si vendbanim i zakonshëm.

CORE TOPICS

2020 Census recommendations	2011 Census recommendations	Shpjegimi
Sipërfaqja dhe numri I dhomave në banesë	X	Sipërfaqja e shfrytëzueshme e dyshemesë' përkufizohet si "sipërfaqja e dyshemesë e matur brenda mureve të jashtme, duke përjashtuar bodrumet dhe papafingot jo të banueshme dhe, në ndërtesat me shumë banesa, të gjithë hapësirat e përbashkëta" Përndryshe, vendet mund të preferojnë të përdorin një koncept tjetër të sipërfaqes së shfrytëzueshme, e përcaktuar si "sipërfaqja e përgjithshme e dhomave brenda banesës" ku koncepti i një a 'Dhoma' është si më poshtë. Një dhomë përcaktohet si një hapësirë e mbyllur nga mure duke filluar nga toka në çati, të paktën me një lartësi 2 metra mbi tokë, me së paku 4 m2. Nëse përdoret ky koncept duhet të jetë e përcaktuar qartë në raportin e censit dhe / ose me të dhënat përkatëse për të shmangur konfuzionin në krahasimet ndërkombëtare.
Sistemi I furnizimit me ujë	X	Merret informacion për sistemin kryesor të furnizimit me ujë dhe nëse ky rrjet zgjatet brenda banesës, jashtë banesë por brenda ndërtesës ose diku tjetër jashtë ndërtesës.
Tualeti	X	Merret informacion në lidhje aksesin në tualet dhe nëse është brenda në banesë, jashtë banesës por brenda në ndërtesë ose diku tjetër jashtë ndërtesës.
Dush/vaskë në banesë	X	Merret informacion nëse NjEF ka një banjë ose dush fiks është ajo e cila ka një lidhje fikse si me sistemin e furnizimit me ujë dhe me sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza jashtë ndërtesës.
Lloji I ngrohjes	X	Merret informacion në lidhje me llojin kryesor të ngrohjes dhe nëse është ngrohje që përdoret për të ngrohur pjesën më të madhe të banesës.
Banesat sipas llojit të ndërtesës	X	Banesat mund të klasifikohen sipas llojit të ndërtesës në të cilën gjenden.
Banesat sipas vitit të ndërtimit të ndërtesës	X	Viti i ndërtimit të ndërtesës është viti në të cilin ndërtesa është përfunduar. Për sa i përket ndërtesave të rinovuara ose ndërtesa të cilat i janë nënshtruar një rikonstruksioni madhor, ky vit do të jetë viti i përfundimit të rikonstruktimit. Për ndërtesat e papërfunduara të cilat përmbajnë të paktën një banesë të banuar, ky vit do të jetë viti që kjo familje ka filluar banimin në këtë banesë.